



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-SC-2025-05/CS002

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 shkurt 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Version i Korrigjuar
i Vendimit mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit
me Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte*

Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit:

Felisiti Geri

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke mbajtur parasysh nenin 51(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullat 196 dhe 197 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe nenet 3, 6 dhe 9-11 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit ("Udhëzuesi i Punës"), pas këshillimeve me gjykatësit e panelit që dha dënimin, lëshon këtë vendim mbi uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit të Ismet Bahtijarit.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 shkurt 2025, Trupi Gjykses I dha vendimin gojor sipas rregullës 94 të Rregullores, me të cilin miratoi marrëveshjen me z. Bahtijari për pranimin e fajësisë, ku ai pranoi fajësinë për një akuzë të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë të frikësimit gjatë procedurës penale, dhe e dënoi atë me dy vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.¹

2. Më 4 shkurt 2025, në përputhje me nenin 3(3) të Udhëzuesit të Punës, Administratorja njoftoi Kryetaren se z. Bahtijari do ta plotësonte kriterin për shqyrtimin e uljes së dënimit më 5 shkurt 2025, kur të kishte vuajtur dy të tretat e dënimit.²

3. Më 5 shkurt 2025, Kryetarja i kërkoi Administratores të mblidhte dhe t'i dorëzonte informacionin e përcaktuar në rregullën 196(3) të Rregullores dhe të ndërmernte hapat e paraparë në nenin 4 të Udhëzuesit të Punës.³

¹ Transkripti, 4 shkurt 2025, f. 616-617.

² KSC/REG/IOR/7630, Njoftim në lidhje me Plotësimin e Kriterit për Shqyrtim për Ulje të Dënimit të z. Ismet Bahtijari, 4 shkurt 2025 (konfidencial).

³ KSC/CHA/PRE/0998, Njoftim mbi Uljen e Dënimeve të zotërinjve Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari, numri i lëndës KSC-SC-2025-01/CS001 dhe KSC-SC-2025-01/CS002, 5 shkurt 2025 (konfidencial).

4. Më 6 shkurt 2025, Mbrojtja dorëzoi Kërkesën e Bahtijarit për Lirim të Parakohshëm drejtuar Kryetares ("Kërkesa e Parë e Bahtijarit"), ku z. Bahtijari kërkoi si më poshtë:

- që shteti i Kosovës si shtet i kryerjes së dënimit, të njoftojë [Dhomat e Specializuara] nëse z. Bahtijari i plotëson kriteret për ulje të dënimit sipas ligjeve të këtij shteti; - që Administratorja ta informojë z. Bahtijari për plotësimin prej tij të kriterit për ulje të dënimit dhe të sigurojë që atij t'i jepet kopje e Udhëzuesit të Punës në një gjuhë që e kupton, dhe ta informojë për hapat e ndërmarrë; - që Administratorja t'i dorëzojë Kryetares brenda një afati më të shkurtër se afati i rregullt prej 21 ditësh dhe me urgjencë, informacionin relevant në përputhje me nenin 1(a)-(f) të Udhëzuesit të Punës; - që të caktojë datën më të hershme të mundshme për paraqitjen nga Bahtijari të parashtrimeve të mëtejshme me shkrim sipas nenit 5(3) të Udhëzuesit të Punës; dhe, - që të caktojë datën më të hershme të mundshme për marrjen e mendimeve të gjykatësve të Trupit Gjykses I në lidhje me uljen e dënimit sipas nenit 6(2) të Udhëzuesit të Punës.⁴

5. Më 7 shkurt 2025, Mbrojtja dorëzoi Kërkesën e Bahtijarit drejtuar Kryetares për Ndryshimin e Afateve të Përcaktuara në Udhëzuesin e Punës mbi Uljen e Dënimit ("Kërkesa e Dytë e Bahtijarit"), ku Bahtijari i kërkon Kryetares si vijon:

- të NDRYSHOJË afatet e përcaktuara në Udhëzuesin e Punës dhe të urdhërojnë lirimin e menjëhershëm të z. Bahtijari; - Si alternativë, të UDHËZOJË Administratoren që informacionin relevant sipas nenit 1(a)-(f) të Udhëzuesit të Punës, t'ia dorëzojë Kryetares deri më 13 shkurt 2025 dhe t'i UDHËZOJË gjykatësit e Trupit Gjykses I që mendimet e tyre në lidhje me uljen e dënimit të z. Bahtijari sipas nenit 6(2) të Udhëzuesit të Punës, t'i japin deri më 16 shkurt 2025.⁵

6. Më 12 shkurt 2025, Administratorja i dorëzoi Kryetares informacionin e mbledhur sipas rregullës 196(3) të Rregullores dhe nenit 5(1) të Udhëzuesit të Punës.⁶ Konkretisht, Administratorja dorëzoi: (i) raportin e Njesisë së Paraburgimit ("NJP" dhe "Raporti i NJP-së"); (ii) raportin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS" dhe "Raporti i ZPS-së"); dhe (iii) parashtrimet e vetë Administratores ("Parashtrimet e Administratores").

7. Më 12 shkurt 2025, në përputhje me nenin 51(2) të Ligjit, rregullën 196(1) të Rregullores dhe nenin 6 të Udhëzuesit të Punës, të gjithë informacionin e marrë

⁴ KSC-BC-2023-10/F00676, Kërkesë e Bahtijarit për Lirim të Parakohshëm drejtuar Kryetares, 6 shkurt 2025 (konfidenciale), para. 46.

⁵ KSC-BC-2023-10/F00678, Kërkesë e Bahtijarit drejtuar Kryetares për Ndryshimin e Afateve të Përcaktuara në Udhëzuesin e Punës mbi Uljen e Dënimit, 7 shkurt 2025 (konfidenciale), para. 28.

⁶ KSC/REG/IOR/7660, Informacioni i Kërkuar sipas Nenit 5 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit në lidhje me z. Ismet Bahtijari, 12 shkurt 2025 (konfidencial).

Kryetarja ua dorëzoi gjykatësve të panelit që dha dënimin dhe u kërkoi të jepnin mendimet e tyre në lidhje me uljen e dënimit të z. Bahtijari, ose, si alternativë, modifikimin ose ndryshimin e dënimit të tij me kushtet që do t'i caktohen për lirim, sikurse përcaktohet në nenet 10 dhe 11 të Udhëzuesit të Punës.⁷

8. Më 17 shkurt 2025, ZPS-ja dorëzoi Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Bahtijarit për Lirim të Parakohshëm.⁸

9. Më 18 shkurt 2025, Mbrojtja dorëzoi Parashtrimet e Bahtijarit drejtuar Kryetares në lidhje me Uljen e Dënimit, ku z. Bahtijari kërkon lirim e menjëhershëm të tij ("Kërkesa e Tretë e Bahtijarit").⁹

10. Duke mbajtur parasysh natyrën e procedurës, Kryetarja nuk e gjykoi të nevojshme të mbante seancë dëgjimore.

II. ANALIZË

11. Fillimisht, Kryetarja vëren se z. Bahtijari ka dorëzuar tre parashtrime në lidhje me uljen e dënimit, me disa kërkesa dhe supozime që nxjerrin në pah disa keqkuptime për procedurën që duhet ndjekur.

12. Kryetarja rikujton se personat e dënuar nga Dhomat e Specializuara e plotësojnë kriterin për *shqyrtim* të uljes së dënimit pasi të kenë vuajtur dy të tretat e dënimit.¹⁰ Plotësimi i kriterit nënkupton shqyrtim dhe *jo të drejtë të vetvetishme* për ulje të dënimit pas vuajtjes së dy të tretave të tij. Rrjedhimisht, ulja, modifikimi ose ndryshimi i dënimit është vendim diskrecional i Kryetares që ajo merr në këshillim

⁷ KSC/CHA/PRE/1003, Ulja e Dënimit – z. Ismet Bahtijari, 12 shkurt 2025 (konfidenciale).

⁸ KSC-BC-2023-10/F00681, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Bahtijarit për Lirim të Parakohshëm, 17 shkurt 2025 (konfidenciale).

⁹ F00001, Parashtrimet e Bahtijarit drejtuar Kryetares në lidhje me Uljen e Dënimit, 18 shkurt 2025 (konfidenciale).

¹⁰ Shih nenin 51(2) të Ligjit; rregulla 196(2) e Rregullores; neni 3(1) i Udhëzuesit të Punës; KSC-SC-2023-01/CS001/F00002, Vendim mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit me Shtojcat Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 12 tetor 2023 (konfidencial), para. 9 ("Vendimi *Gucati*").

me gjykatësit e Dhomave të Specializuara në bazë të “interetit të drejtësisë dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës”,¹¹ dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara. Gjithashtu, Kryetarja nuk ka “detyrimin e provës” për të demonstruar se personi i dënuar nuk e ka plotësuar kriterin për lirim me kushte.¹²

13. Kryetarja rikujton se në bazë të Ligjit, Rregullores dhe Udhëzuesit të Punës, ajo ka kompetencë për të shqyrtuar vetëm plotësimin nga personi i dënuar të kriterit për ulje, modifikim ose ndryshim të dënimit, dhe jo aktgjykimet e shqiptuara nga panelet kompetente.¹³

14. Gjithashtu, para se të marrë vendim, Kryetarja mban parasysh mendimet e gjykatësve të panelit që dha dënimin, edhe pse në këtë vendim nuk do të merret me analizën e tyre. Kryetarja do t'i shqyrtojë faktorët e përcaktuar në rregullën 196(3) të Rregullores dhe do të vendosë, mbi bazën e fakteve të çështjes, nëse ka faktorë të mjaftueshëm që përligjin uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit të z. Bahtijari.

a) Distancimi i njëmendtë prej veprës penale

15. Ndonëse Administratorja parashtron se nuk është raportuar që z. Bahtijari t'u ketë shprehur punonjësve të NJP-së pendim apo keqardhje për veprat penale për të cilat u dënua,¹⁴ në Kërkesën e Parë të Bahtijarit, Mbrojtja thekson se z. Bahtijari “ka shprehur pendim të njëmendtë gjatë seancës mbi marrëveshjen për pranimin e fajësisë më 19 dhjetor 2024”.¹⁵

16. Në këtë kontekst, Kryetarja mban parasysh komentet e z. Bahtijari, të përmendura në Parashtrimet e Administratores, kur u pyet nga Trupi Gjykses “nëse

¹¹ Neni 51(2) i Ligjit.

¹² Vendimi *Gucati*, para. 9.

¹³ Vendimi *Gucati*, para. 10.

¹⁴ Parashtrimet e Administratores, para. 30.

¹⁵ Kërkesa e Parë e Bahtijarit, para. 23.

ishte penduar për veprimet e tij sipas fakteve të pranuar dhe nëse mendonte që veproi gabim ose keq”.¹⁶ Z. Bahtjari deklaroi:

Kryegjykatësja: “[...] çfarë dëgjova. A konfirmoni se ishte gabim ajo që bëtë? Këtë po thoni? Nuk dua t’ju diktoj fjalët, por a po thoni se tani mendoni se ajo që bëtë atëherë ishte gabim?”

Z. Bahtjari: “Po, q’ashtu.”¹⁷

17. Gjithashtu, në raportin e NJP-së pasqyrohet se z. Bahtjari e kupton pse u dënua dhe pse ndodhet në burg.¹⁸

18. ZPS-ja nuk raporton për ndonjë distancim të njëmendtë të z. Bahtjari nga veprat penale, por vetëm thekson se para marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe në fazën kur z. Bahtjari dha deklaratë me vullnet të lirë, ai nuk pranoi se kishte bërë shkelje dhe e gënjeu ZPS-në.¹⁹

19. Duke pasur parasysh sa më lart dhe së bashku me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, përmes së cilës z. Bahtjari pranon veprat penale, Kryetarja gjykon se pendimi i shprehur është i njëmendtë dhe se z. Bahtjari ka vendosur të distancohet nga ato veprime.

20. Rrjedhimisht, Kryetarja konstaton se ky faktor shkon në favor të uljes, modifikimit ose ndryshimit të mundshëm të dënimit të z. Bahtjari.

b) Shenja të rehabilitimit

21. Z. Bahtjari parashtron se ka treguar shenja të qarta të rehabilitimit, ndër të cilat sjellje të mirë, integritet dhe kujdes për të tjerët, që tregojnë se ka “gjasa reale për rehabilitim”.²⁰

¹⁶ Parashtrimet e Administratores, para. 31.

¹⁷ Parashtrimet e Administratores, para. 31.

¹⁸ Raporti i NJP-së, para. 8.

¹⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 8.

²⁰ Kërkesa e Parë e Bahtjarit, para. 25-26.

22. Se z. Bahtijari ka treguar shenja të rehabilitimit konfirmohet edhe në Parashtrimet e Administratores, veçanërisht në Raportin e NJP-së, ku theksohet se ai “ka treguar sjellje miqësore, të përgjegjshme dhe respektuese” dhe se “nuk ka shfaqur sjellje agresive, të papërshtatshme apo vetëdëmtuese, nuk ka qenë objekt i ndonjë mase disiplinore, dhe as nuk i është tërhequr vërejtje zyrtarisht”.²¹ Për më tepër, z. Bahtijari tregon shenja rehabilitimi edhe me përfshirjen e tij në aktivitete në objektin e paraburgimit, me sjelljen e tij gjatë kryerjes së detyrave të caktuara dhe me reagimin e tij ndaj kritikave.²²

23. Rrjedhimisht, Kryetarja gjykon se z. Bahtijari ka treguar shenja të qarta rehabilitimi dhe konstaton se ky faktor shkon në favor të uljes, modifikimit ose ndryshimit të mundshëm të dënimit të z. Bahtijari.

c) Gjasat e rishoqërizimit dhe riintegritit të suksesshëm

24. Z. Bahtijari parashtron se ka lidhje të forta me familjen dhe komunitetin dhe se ka pasur mbështetje të vazhdueshme morale prej tyre, çka tregon gjasat e rishoqërizimit dhe riintegritit të suksesshëm të tij pas lirimit.²³

25. Në Raportin e NJP-së konfirmohet se z. Bahtijari ka një lidhje të qëndrueshme me familjen, rrjet të gjerë shoqëror dhe mjedis të qëndrueshëm jetese, që mund të mbështesin integrimin në jetën normale dhe rishoqërizimin e tij pas lirimit.²⁴

26. Kryetarja është e mendimit se lidhjet e ngushta familjare dhe rrjeti shoqëror i z. Bahtijari me gjasë do ta ndihmojnë në përshtatjen dhe integrimin e tij në Kosovë, në qoftë se lirohet.

27. Rrjedhimisht, Kryetarja gjykon se ky informacion është faktor pozitiv për

²¹ Raporti i NJP-së, para. 9-14.

²² Raporti i NJP-së, para. 15-21.

²³ Kërkesa e Parë e Bahtijarit, para. 25-27.

²⁴ Raporti i NJP-së, para. 23, 25.

vlerësimin nëse për z. Bahtijari do të miratohet ulje, modifikim ose ndryshim i dënimit.

d) Pesha e veprave penale për të cilat u dënua personi

28. Z. Bahtijari pretendon se veprat penale për të cilat u dënua “nuk kanë pasur pasoja të përhershme ose të rënda [sic] për rendin publik ose administrimin e drejtësisë” dhe se roli dhe veprimet e z. Bahtijari u kufizuan vetëm te një ofertë ose dhuratë gjatë një vizite te dëshmitari brenda një periudhe të shkurtër prej një jave.²⁵

29. ZPS-ja parashtrohet se veprat penale për të cilat u dënua z. Bahtijari përbëjnë “cenim të rëndë të sigurisë dhe integritetit të proceseve gjyqësore” dhe se ndërhyrja e z. Bahtijari ishte “e konsiderueshme”.²⁶ ZPS-ja gjithashtu parashtrohet se këto vepra penale kanë “ndikim negativ tek besimi i publikut në efikasitetin e urdhrave dhe të vendimeve të [Dhomave të Specializuara], përfshirë të atyre që kanë të bëjnë me masa mbrojtëse”.²⁷ ZPS-ja parashtrohet se, rrjedhimisht, këta faktorë peshojnë kundër uljes së dënimit të z. Bahtijari.²⁸

30. Kryetarja thekson se ndonëse sjellja e z. Bahtijari, e pranuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ishte në formën e ofrimit të përfitimit dhe jo në formën e kërcënimit ose dëmtimit të drejtpërdrejtë të dëshmitarit, nuk mund të arrihet në përfundimin e sugjeruar në Kërkesën e Parë të z. Bahtijari se kjo sjellje nuk ka pasoja të përhershme ose të rënda për administrimin e drejtësisë. Përkundrazi, ka një aspekt shumë të rëndësishëm që rrezikohet, që është se kjo sjellje rezulton në komprometimin e integritetit të administrimit të drejtësisë dhe procesit të paanshëm të zbulimit të fakteve. Ky rrezik është i pranishëm pavarësisht nëse përdoret dhunë dhe kërcënime të hapura, apo nxitje e një forme më të butë. Ndonëse mënyra të ndryshme të ndikimit

²⁵ Kërkesa e Parë e Bahtijarit, para. 28-29.

²⁶ Raporti i ZPS-së, para. 3-4.

²⁷ Raporti i ZPS-së, para. 5.

²⁸ Raporti i ZPS-së, para. 3-7.

mund të kenë efekte të menjëhershme të ndryshme mbi një dëshmitar, qëllimi përfundimtar i të akuzuarit është të manipulojë rezultatin e një procesi të pavarur dhe të paanshëm me metoda kriminale. Kjo ndërhyrje dëmton legjitimitetin më të gjerë të një sistemi gjyqësor të drejtë dhe të efektshëm. Në këtë kontekst, çdo veprim i drejtuar kundër një dëshmitari nuk duhet të kuptohet si veprim i izoluar kundër një personi, por si mjet që synon të dëmtojë integritetin e përgjithshëm të procesit gjyqësor.

31. Edhe sa u përket personave në fjalë, sjellja e z. Bahtijari pati ndikim negativ jo vetëm mbi dëshmitarin konkret dhe familjen e tij, por edhe mbi dëshmitarë të tjerë që mund të paraqiten para Dhomave të Specializuara. Kryetarja gjithashtu mban parasysh se pesha e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë, në veçanti frikësimi i dëshmitarëve, është pranuar në jurisprudencën e Dhomave të Specializuara, dhe se sjellja e z. Bahtijari, pavarësisht formës së saj, nuk zvogëlon peshën e vetë veprës penale.

32. Për më tepër, Kryetarja gjykon se deklaratat e viktimës 1 se lirimi i z. Bahtijari nuk do të krijonte shqetësime për sigurinë e tij dhe të familjes, nuk kanë asnjë ndikim në faktorët që përcaktojnë peshën e veprës penale, duke qenë se vlera e mbrojtur me ndalimin e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë është në radhë të parë ruajtja e integritetit të administrimit të drejtësisë.

33. Rrjedhimisht, Kryetarja konstaton se ky faktor peshon kundër uljes së dënimit të z. Bahtijari.

e) Trajtimi i të burgosurve të tjerë në rrethana të ngjashme

34. Në Raportin e NJP-së thuhet se në dy çështje gjyqësore të mëparshme para Dhomave të Specializuara, dënimet u rishikuan pasi personat e dënuar kishin vuajtur dy të tretat e dënimit.²⁹

²⁹ Raporti i NJP-së, para. 26.

35. Kryetarja vëren se ky është rasti i katërt ku persona të dënuar nga Dhomat e Specializuara kanë vuajtur dy të tretat e dënimit. Rrjedhimisht, Kryetarja konstaton se ka raste të tjera të burgosurish në rrethana të ngjashme, çka është faktor pozitiv që peshon për uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit të z. Bahtijari.

f) A do të shkaktonte lirimi paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme

36. Z. Bahtijari parashtron se lirimi i tij nuk do të ketë ndikim në “rrethanat shoqërore dhe rendin publik në Kosovë”, pasi ai nuk është i përfshirë në politikë.³⁰

37. Administratorja parashtron se sipas vlerësimit të Njesisë së Sigurisë (“NJS”), lirimi i z. Bahtijari do të “shkaktojë një reagim publik të kufizuar [dhe se] gjasa që kjo të shkaktojë një nivel të tillë trazirash civile që mund të konsiderohet paqëndrueshmëri shoqërore [e konsiderueshme], pritet të jetë shumë e vogël”.³¹ Për më tepër, z. Bahtijari nuk ka një profil apo rol politik që mund të konsiderohet se krijon paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme.³²

38. Kryetarja thekson se NJS-ja kreu vlerësim rrënjësor të rrezikut në lidhje me këtë aspekt, të cilit Kryetarja i kushton rëndësi të konsiderueshme. Pasi ka shqyrtuar informacionin që i është paraqitur, Kryetarja është e mendimit se rreziku që lirimi i z. Bahtijari të shkaktojë paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme në Kosovë, është shumë i ulët.

39. Rrjedhimisht, Kryetarja vlerëson se ky faktor shkon në favor të uljes, modifikimit ose ndryshimit të mundshëm të dënimit të z. Bahtijari.

g) A ka pasur bashkëpunim të konsiderueshëm me ZPS-në

40. Z. Bahtijari parashtron se ka bashkëpunuar me ZPS-në gjatë gjithë kohës që nga

³⁰ Kërkesa e Parë e Bahtijarit, para. 31.

³¹ Parashtrimet e Administratores, para. 16.

³² Parashtrimet e Administratores, para. 17-19.

arrestimi i tij, dhe se ky bashkëpunim nuk duhet të shihet thjesht vetëm te pranimi i fajësisë.³³

41. ZPS-ja pretendon se bashkëpunimi i kufizuar i z. Bahtijari në formën e marrëveshjes për pranimin e fajësisë u arrit vetëm pas debateve juridike të shumta dhe vetëm pak para fillimit të gjykimit, dhe se ky lloj bashkëpunimi tashmë është marrë parasysh sipas rregullës 163(2) të Rregullores dhe rrjedhimisht nuk duhet të jetë faktor për t'u marrë në konsideratë në favor të uljes së dënimit.³⁴

42. Kryetarja pajtohet me ZPS-në se marrëveshja për pranimin e fajësisë më vete u pranua dhe u morr parasysh mjaftueshëm sipas rregullës 163(2) të Rregullores, dhe se në favor të uljes së dënimit nuk mund të merret në konsideratë vetëm ky faktor.

43. Kryetarja vëren se nuk ka tregues se z. Bahtijari bashkëpunoi me ZPS-në përtej marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Rrjedhimisht, Kryetarja e konsideron këtë si faktor neutral për vlerësimin nëse për z. Bahtijari do të miratohet ulje, modifikim ose ndryshim i dënimit.

h) Ndihma e dhënë vullnetarisht nga personi i dënuar për të mundësuar zbatimin e aktgjykimeve dhe urdhrave të Dhomave të Specializuara

44. Z. Bahtijari parashtroi se nuk ka qenë në pozitë për të mundësuar zbatimin e aktgjykimeve dhe urdhrave të Dhomave të Specializuara.³⁵

45. Administratorja theksoi se nuk ka informacion për ndonjë ndihmë të dhënë vullnetarisht nga z. Bahtijari për të mundësuar zbatimin e aktgjykimeve dhe urdhrave të Dhomave të Specializuara për çështje të tjera.³⁶

46. Meqenëse z. Bahtijari nuk ka qenë në pozitë të ndihmojë në lidhje me zbatimin

³³ Kërkesa e Parë e Bahtijarit, para. 22.

³⁴ Raporti i ZPS-së, para. 8.

³⁵ Kërkesa e Parë e Bahtijarit, para. 33.

³⁶ Parashtrimet e Administratores, para. 20.

e aktgjyckimeve dhe urdhreve të Dhomave të Specializuara në çështje të tjera, Kryetarja është e mendimit se ky është faktor neutral për vlerësimin e uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit të z. Bahtijari.

- i) Veprime të qenësishme të ndërmarra nga i dënuari në të mirë të viktimave, si dhe pasojat për viktimat dhe familjet e tyre në rast të uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit

47. Z. Bahtijari parashtrohet se është i vetmi person i dënuar që Trupi Gjyckues nuk e urdhëroi të paguante zhdëmtime, dhe ai zotohet të mos kontaktojë më viktimën si një formë kompensimi.³⁷

48. Administratorja parashtrohet se viktimat 1 thekson se lirimi i z. Bahtijari “nuk i krijon shqetësim për sigurinë e vet dhe të familjes”.³⁸

49. Meqenëse Trupi Gjyckues nuk e urdhëroi z. Bahtijari që t’i paguante zhdëmtim viktimës 1, Kryetarja do ta konsiderojë këtë si faktor neutral në kuadër të vlerësimit të uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit të z. Bahtijari.

- j) Rrethanat personale të personit të dënuar

50. Kryetarja vëren se në lidhje me këtë faktor nuk është paraqitur informacion i konsiderueshëm dhe, rrjedhimisht, do ta konsiderojë atë si neutral në kuadër të vlerësimit të uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit të z. Bahtijari.

- k) Faktorë të tjerë që vërtetojnë ndryshim të qartë dhe të konsiderueshëm të rrethanave, të mjaftueshëm për të përligjur uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit

51. ZPS-ja pretendon se janë ende shumë dëshmitarë të tjerë që duhet të dëshmojnë

³⁷ Kërkesa e Parë e Bahtijarit, para. 33.

³⁸ Parashtrimet e Administratores, para. 21.

në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* deri në prill 2025, çka përbën edhe një arsye më shumë për të siguruar që z. Bahtijari të vuajë dënimin e plotë “sepse kështu [ai] do të vazhdoj[ë] të je[të] në burg kur Gjykata të dëgjojë dëshmi të rëndësishme”.³⁹

52. Kryetarja nuk bindet nga argumentet e përgjithshme të ZPS-së se ulja, modifikimi ose ndryshimi i dënimit duhet të kushtëzohen nga dëshmitë që janë duke u dhënë në procese të tjera, pa përmendur ndonjë rrethanë apo rrezik konkret. Kryetarja gjithashtu vëren se ka shumë të ngjarë që paraqitja e provave të ZPS-së në çështjen kundër *Hashim Thaçit dhe të tjerëve* të përfundojë në prill 2025.⁴⁰ Për më tepër, parashtrimet e ZPS-së janë shumë të përgjithshme për t’u interpretuar si shqetësim i përligjur se z. Bahtijari do të përsërisë veprat penale ndërsa po jepen dëshmi para Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, Kryetarja nuk e gjykon këtë informacion si relevant për vlerësimin e uljes, modifikimit ose ndryshimit të dënimit të z. Bahtijari.

III. ULJA E DËNIMIT

53. Kryetarja thekson se sipas nenit 51(2) të Ligjit, personi i dënuar e plotëson kriterin për shqyrtim për ulje të dënimit pasi të ketë vuajtur dy të tretat e dënimit.

54. Kryetarja rikujton se z. Bahtijari u vetëdeklarua fajtor dhe lidhi marrëveshje për pranimin e fajësisë. Z. Bahtijari ka demonstruar shenja pozitive të distancimit nga veprat penale për të cilat u dënua, ka shprehur synimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, dhe ka treguar sjellje pozitive gjatë kohës së paraburgimit në objektin e paraburgimit. Sidoqoftë, veprat penale për të cilat u dënua janë të rënda, pavarësisht nga dënimi relativisht i ulët që mori.

55. Kryetarja thekson se ulja e dënimit nënkupton lirimin e menjëhershëm të personit të dënuar, çka nuk mundëson vendosjen e kushteve të lirisë. Duke mbajtur parasysh llojin e veprave penale për të cilat u dënua z. Bahtijari dhe ndikimin mjaft

³⁹ Raporti i ZPS-së, para. 10.

⁴⁰ Transkripti i 1 tetorit 2024, f. 20535.

negativ të veprimeve të tij mbi dëshmitarë të mundshëm në të ardhmen, si dhe pasi ka marrë parasysh interesat e drejtësisë dhe parimet e përgjithshme të së drejtës duke u bazuar në faktet e çështjes, Kryetarja gjykon se ulja e dënimit nuk është e përshtatshme. Rrjedhimisht, Kryetarja nuk miraton uljen e dënimit të z. Bahtijari.

56. Kryetarja për rrjedhojë do të vendosë nëse do të modifikojë ose ndryshojë dënimin e z. Bahtijari, në përputhje me nenin 51(2) të Ligjit dhe nenin 10 të Udhëzuesit të Punës.

IV. MODIFIKIMI OSE NDRYSHIMI I DËNIMIT

57. Sipas nenit 51(2) të Ligjit, lexuar së bashku me nenet 3(1) dhe 10 të Udhëzuesit të Punës, kur konstaton se ulja e dënimit nuk është e përshtatshme, Kryetarja mund të vendosë ta modifikojë ose ndryshojë dënimin që i është shqiptuar personit të dënuar pasi personi të ketë vuajtur dy të tretat e dënimit. Për këtë qëllim, Kryetarja mund ta modifikojë ose ndryshojë dënimin e personit të dënuar dhe të urdhërojë lirimin e tij me disa kushte specifike. Këto kushte janë në fuqi gjatë gjithë kohëzgjatjes së dënimit me burgim që i është shqiptuar personit të dënuar, ose deri më një datë të mëhershme të caktuar.⁴¹ Në përputhje me nenin 11(2) të Udhëzuesit të Punës, Kryetarja mund të vendosë të anulojë ose ndryshojë vendimin e vet nëse personi i dënuar shkel një ose më shumë prej kushteve që i janë caktuar.

58. Kryetarja gjykon se veprat penale për të cilat u dënua z. Bahtijari janë padyshim të rënda, duke marrë parasysh ndikimin që ka frikësimi i dëshmitarëve mbi administrimin e drejtësisë. Sidoqoftë, Kryetarja konstaton se ka disa faktorë që peshojnë në favor të modifikimit të dënimit të z. Bahtijari me anë të lirimit të tij, megjithëse me kushte.

59. Kryetarja rikujton se: (i) z. Bahtijari u vetëdeklarua fajtor dhe, rrjedhimisht,

⁴¹ Shih nenin 11(1) të Udhëzuesit të Punës.

lidhi marrëveshje për pranimin e fajësisë, dhe ka treguar shenja të distancimit të njëmendtë nga veprat penale për të cilat u dënua; (ii) z. Bahtijari ka treguar shenja pozitive të rehabilitimit; (iii) gjasat që lirimi i z. Bahtijari të shkaktojë paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme në Kosovë janë të vogla; (iii) z. Bahtijari ka lidhje të qëndrueshme familjare dhe shoqërore, që do të ndihmonin riintegrimin e tij në Kosovë; dhe (iv) vështirësitë mendore që lidhen me largimin nga familja e tij, veçanërisht nga nëna, e cila ka probleme shëndetësore. Kryetarja mban parasysh se z. Bahtijari gjithashtu ka deklaruar bindshëm se do t'u përmbahet të gjitha kushteve që mund t'i caktohen në lidhje me lirimin.⁴²

60. Kryetarja gjykon se gjatë vuajtjes së mbi dy të tretave të dënimit, z. Bahtijari ka pasur mundësi të reflektojë për veprimet e veta dhe e vlerëson të njëmendtë keqardhjen që z. Bahtijari shprehu para Trupit Gjykses.

61. Rrjedhimisht, megjithëse dënimi i z. Bahtijari mbetet sikurse është shqiptuar nga Trupi Gjykses, Kryetarja është e mendimit se dënimi duhet të modifikohet në lirim të z. Bahtijari me kushte. Kryetarja thekson se kushtet që do të caktohen do t'i japin z. Bahtijari mundësinë të demonstrojë se vazhdon të ecë drejt rehabilitimit të plotë dhe se do t'u përmbahet të gjitha urdhrave që mund të lëshojnë Dhomat e Specializuara në të ardhmen, sipas rastit.

62. Duke pasur parasysh sa më lart, dhe pasi ka shqyrtuar tërësinë e informacionit që i është paraqitur, si dhe mendimet e gjykatësve të Trupit Gjykses që shqiptoi dënimin, Kryetarja vendos që për lirimin e z. Bahtijari, në përputhje me nenin 11(1) të Udhëzuesit të Punës, për pjesën e mbetur të dënimit të shqiptuar nga Trupi Gjykses, të zbatohen kushtet në vijim:

a) të garantojë se do të banojë tërë kohën në adresën e shtëpisë të përcaktuar

⁴² Kërkesa e Parë e Bahtijarit, para. 42-43.

në Parashtrimet e Administratores;⁴³

- b) të informojë Administratoren dhe stacionin e policisë të identifikuar nga Administratorja për ndërrimin e vendbanimit të përhershëm, në varësi të miratimit nga Kryetarja;
- c) të paraqitet çdo javë në stacionin e policisë të identifikuar nga Administratorja;
- d) Administratores t'i dorëzohet pasaporta ose dokumentet e udhëtimit të z. Bahtijari;
- e) të qëndrojë në Kosovë dhe të informojë Administratoren në rast se dëshiron të udhëtojë jashtë Kosovës, dhe kërkesa për leje për udhëtim të miratohet nga Kryetarja;
- f) të mos kontaktojë, as të komunikojë me viktimën 1 dhe bashkëshorten, familjen e tyre dhe të afërm të tjerë;
- g) të mos kontaktojë, as të komunikojë me dëshmitarë ose viktimë (të mundshme) para Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së;
- h) të mos japë deklarata publike drejtpërdrejt ose tërthorazi lidhur me Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në;
- i) të kërkojë leje dhe miratim nga Administratorja për intervista me mediat, sikurse përcaktohet në Udhëzuesin e Punës për të Paraburgosurit (Komunikimet me Mediat);
- j) të përmbushë vendimet ose urdhrat e Dhomave të Specializuara; dhe
- k) të mos bëjë komente negative, të dhunshme, frikësuese, kërcënuese ose

⁴³ Parashtrimet e Administratores, para. 13.

shtrënguese ndaj ose rreth dëshmitarëve (të mundshëm) ose personave të tjerë që janë të rrezikuar për shkak të bashkëpunimit të tyre me Dhomat e Specializuara, dhe ndaj ose rreth zyrtarëve të Dhomave të Specializuara ose të ZPS-së.

63. Kryetarja thekson se kushtet e përcaktuara më lart lidhur me lirimin e z. Bahtijari mbeten në fuqi për pjesën e mbetur të dënimit prej dy vjetësh të shqiptuar nga Trupi Gjykses, përkatësisht deri më 4 tetor 2025. Kryetarja gjithashtu thekson se mospërbushja prej z. Bahtijari e kushteve të përcaktuara në paragrafin 62 do të rezultojë në anulimin ose ndryshimin e vendimit aktual në përputhje me nenin 11(2) të Udhëzuesit të Punës.

V. PËRFUNDIM

64. Pasi shqyrtoi me kujdes informacionin që i është paraqitur, përfshirë mendimet e gjykatësve të panelit që shqiptoi dënimin, si dhe duke pasur parasysh interesat e drejtësisë dhe parimet e përgjithshme të së drejtës bazuar në faktet e kësaj çështjeje, Kryetarja vendos se ulja e dënimit nuk është e përshtatshme. Kryetarja do të modifikojë dënimin e z. Bahtijari, për të mundësuar lirimin e tij me kushtet e përcaktuara në paragrafin 62 më lart.

65. Në këtë aspekt, Kryetarja vë në dukje se veprat penale për të cilat është dënuar z. Bahtijari janë të rënda dhe ndonëse ai ka treguar shenja të njëmendta të distancimit nga veprat penale dhe disa shenja pozitive të rehabilitimit, është me rëndësi të sigurohet vazhdimi i rehabilitimit dhe distancimit të plotë të z. Bahtijari, përmes përmbushjes së kushteve të përcaktuara në paragrafin 62 më lart. Duke marrë parasysh se dënimi modifikohet me këtë vendim, rishikimi lidhur me ndryshimin e dënimit është i tejkaluar.

66. Së fundi, në lidhje me Kërkesën e Parë, Kërkesën e Dytë dhe Kërkesën e Tretë të Bahtijarit, Kryetarja gjykon se me lëshimin e këtij vendimi, masat e kërkuara në to

bëhen të panevojshme.

VI. VENDIM

67. Bazuar në sa më lart, Kryetarja:

VENDOS se ulja e dënimit të z. Bahtijari nuk është e përshtatshme dhe rrjedhimisht nuk miratohet;

VENDOS të modifikojë dënimin e z. Bahtijari duke e liruar me kushtet e përcaktuara në paragrafin 62 më lart;

VENDOS që, në varësi të organizimit të transferimit nga Administratorja, z. Bahtijari të lirohet më 21 shkurt 2025, në vendbanimin e tij të përhershëm, në adresën e shtëpisë të përcaktuar në Parashtrimet e Administratores;

URDHËRON z. Bahtijari të përmbushë kushtet e përcaktuara në paragrafin 62 më lart;

URDHËRON Administratoren të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar transferimin e z. Bahtijari në adresën e shtëpisë së tij dhe kushtet e përcaktuara në paragrafin 62 më lart;

URDHËRON policinë e Kosovës ose çdo autoritet tjetër në Kosovë që, në përputhje me nenin 53 (1) të Ligjit, të bashkëpunojë me Administratoren për zbatimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 62 më lart dhe t'i dorëzojë Administratores raport mujor lidhur me përmbushjen prej z. Bahtijari të kushteve të përcaktuara në paragrafin 62(c) më lart;

URDHËRON Administratoren t'i raportojë Kryetares çdo dy muaj lidhur me përmbushjen prej z. Bahtijari të kushteve të përcaktuara në paragrafin 62 më lart, deri në përfundimin e dënimit të tij prej dy vjetësh, përkatësisht më 4 tetor 2025, ose më herët në rast të shkeljes së kushteve;

URDHËRON Njësinë për Administrimin e Gjykatës ("NJAGJ") që këtë vendim t'ua dorëzojë zotit Bahtijari, mbrojtëses së tij dhe Prokurores së Specializuar vetëm pas konfirmimit të mbërritjes së z. Bahtijari në Kosovë;

URDHËRON NJAGJ-në ta riklasifikojë këtë vendim si publik pas konfirmimit të Administratores për mbërritjen e z. Bahtijari në vendin e caktuar të lirit;

URDHËRON NJAGJ-në të sigurojë që Shtojcat e këtij vendimi të mbeten konfidenciale dhe *ex parte*; dhe

RRËZON si të tejkaluara Kërkesën e Parë, Kërkesën e Dytë dhe Kërkesën e Tretë të z. Bahtijari.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 19 shkurt 2025
Në Hagë,
Holandë

Shënim shpjegues

Numri i lëndës në ballinë dhe në fund të faqes u ndryshua nga KSC-SC-2025-01/CS002 në KSC-SC-2025-05/CS002.